

PROCESVERBAL – Tipi i kontratës-PUNË

**PËR ARGUMENTIMIN DHE MIRATIMIN E SPECIFIKIMEVE TEKNIKE DHE
KRITEREVE PËR KUALIFIKIM**

(Ky procesverbal është për efekt publikimi bashkë me dokumentet e tenderit)

Objekti i prokurimit: *Ndërtimi i shëtitores “Bashkim Gazidede”Bathore*

Kodi përkatës në fjalorin e përbashkët të prokurimit (CPV): 452332120-6, Punime ndërtimi për rrugë.

Vlera e fondit limit: 45,833,333 *(dyzet e pesë milion e tetëqind e tridhjetë e tre mijë e treqind e tridhjetë e tre) lekë pa TVSH.*

Argumentimi : Përlllogaritja e vlerës limit të kontratës është referuar në preventivin e përlllogaritur mbështetur në VKM nr. 629, datë 15.07.2015 “Për miratimin e manualeve teknike të çmimeve të punimeve të ndërtimit dhe të analizave teknike të tyre”.

Në bazë të Nenit 21, pika 2, të Ligjit Nr. 162/2020 “Për Prokurimin Publik”; Nenit 2, pika 2/c si dhe Nenit 78, pika 2, të VKM Nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, Autoriteti Kontraktor, **Bashkia Kamëz**, ka hartuar procesverbalin për argumentimin dhe miratimin e specifikimeve teknike dhe kriterëve për kualifikim për procedurën e sipërcituar, me përmbajtjen si më poshtë:

2. KRITERET E VEÇANTA TË KUALIFIKIMIT

1. Ofertuesi duhet të paraqesë:

a. *Formularin Përmbledhës të Vetëdeklarimit, sipas shtojcës 8,*

Argumentimi: Kërkesa e mësipërme bazohet në VKM Nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, Kreu V, Seksioni III, Neni 39, pika 7, gërma “ç” (sipas Shtojcës 1 te DST).

b. *Sigurimin e Ofertës, sipas Shtojcës 3;*

c. *Formulari i ofertes sipas Shtojcës 1*

Argumentimi: Kërkesa e mësipërme për sigurimin e ofertës mbështetet në Ligjin Nr. 162/2020 “Për Prokurimin Publik”, Neni 83, pika 1 si dhe në VKM Nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, Kreu V, Seksioni II, Neni 30, pika 1.

Kërkesa për Formularin Përmbledhës të Vetëdeklarimit bazohet në Ligjin Nr. 162/2020 “Për Prokurimin Publik”, Neni 82 si dhe në VKM Nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, Kreu V, Seksioni II, Neni 26.

2. Ofertuesi duhet të paraqesë:

2.1 Përshtatshmëria për të kryer veprimtarinë profesionale: Sipas Shtojcës 7 të DST.

Argumentimi: Kërkesa e mësipërme bazohet në Nenin 77, pika 1/a dhe pika 2, të Ligjit Nr. 162/2020 “Për Prokurimin Publik”; si dhe Kreu V, Seksioni III, Neni 39, pika 6, të VKM-së Nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”.

2.2 Kapaciteti ekonomik dhe financiar:

1. Për të vërtetuar një aktivitet pozitiv të qëndrueshëm Operatori ekonomik duhet të paraqesë Kopjetë çertifikuara të bilanceve të 3 (tri) viteve të fundit financiare (2019, 2020, 2021) të paraqitur në Autoritetet përkatëse Dega e Tatim Taksave të konfirmuara nga ky Autoritet si dhe të shoqëruar me Akt Ekspertizën e Ekspertit Kontabel të Autorizuar. (Kjo kërkesë do të konsiderohet e përmbushur nëse në dy bilance të njëpasnjëshme, nuk ka raport negative ndërmjet aktivitetit dhe pasivitetit).

Argumentimi: Kërkesa e mësipërme mbështetet në Nenin 77, pika 3, të Ligjit Nr. 162/2020 “Për Prokurimin Publik”; si dhe Kreu V, Seksioni III, Neni 43, pika 4, të VKM Nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”. Përcaktimi i viteve të kërkuara për paraqitjen e bilanceve është bërë duke iu referuar legjislacionit të fushës, konkretisht, Ligjit Nr. 10091 datë 5.3.2009 “Per auditimin ligjor, organizimin e profesionit të ekspertit kontabel të regjistruar dhe të kontabilistit të miratuar” (i ndryshuar).

Shënim: Akt Ekspertizë e Ekspertit Kontabel të Autorizuar, duhet të paraqitet nga OE vetëm në rastin kur janë në kushtet e përcaktimeve të nenit 41, gërma “c” të Ligjit nr. 10091, datë 05.03.2009 “Për auditimin ligjor, organizimin e profesionit të ekspertit kontabel të regjistruar dhe të kontabilistit të miratuar”, i ndryshuar, ku parashikohet se: “Personat juridikë që detyrohen për auditimin ligjor të pasqyrave financiare detyrohen të kryejnë auditimin ligjor të pasqyrave financiare vjetore, përpara publikimit të tyre, nga eksperte kontabel ose shoqëri audituese: "c) shoqëritë me përgjegjësi të kufizuar, të cilat zbatojnë për raportimin financiar standardet kombëtare të kontabilitetit, kur, në mbyllje të periudhës kontabel, për dy vite radhazi, tejkalojnë dy prej tre treguesve të mëposhtëm: i) totali i aktiveve të bilancit, në mbyllje të periudhës kontabel përkatëse, arrin ose e kalon shumën prej 50 milionë lekësh; ii) shuma e të ardhurave nga veprimtaria ekonomike (qarkullimi) në atë periudhë kontabel arrin ose e kalon shumën prej 100 milionë lekësh; iii) ka, mesatarisht, 30 të punësuar gjatë periudhës kontabel

2. Kopje të deklaratave të xhiros vjetore të lëshuara nga administrata tatimore për vitet (2019, 2020, 2021), ku vlera e xhiros **për të paktën një nga vitet e periudhës së kërkuar** duhet të jetë jo mëe vogël se vlera e parashikuar të kontratës që po prokurohet pa TVSH. (Kjo kërkesë do të konsiderohet e përmbushur nëse Operatori ekonomik arrin vlerën e xhiros minimale në të paktën një vit të periudhës së kërkuar nga Autoriteti Kontraktor).

Argumentimi: Kërkesa e mësipërme mbështetet në Nenin 77, pika 3, të Ligjit Nr. 162/2020 “Për Prokurimin Publik” si dhe në Kreun V, Seksioni III, Neni 43, pika 2 dhe pika 3 e VKM-së Nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”. Kërkesat e renditura sipas Kapacitetit ekonomik dhe financiar (pika 1 dhe pika 2) i shërbejnë Autoritetit Kontraktor, për të

provuar nëse Ofertuesit zotërojnë kapacitet financiar për të përmbushur me sukses kontratën objekt prokurimi.

3. Vërtetim për shlyerjen e taksave vendore të parashikuara nga Pushteti Vendor për vitin 2021 ku të përfshihet kësti për periudhën përkatëse të maturuar për vitin 2022 sipas përcaktimeve të Ligjit Nr. 9632, datë 30.10.2006 “Për sistemin e taksave vendore”, (i ndryshuar). (Në rastet e bashkimit të operatorëve ekonomikë, çdo anëtar i grupit duhet të dorëzojë vërtetimin lëshuar nga Autoriteti përkatës në të cilën është regjistruar sipas QKB).

(Kjo kërkesë do të konsiderohet e përmbushur gjatë fazës së ofertimit me plotësimin e formularit të vetedeklarimit, këto dokumente do të paraqiten nga operatori ekonomik i klasifikuar i pari, përpara publikimit të njoftimit të fituesit dhe nisjes së afateve të ankimit).

Argumentimi: Kërkesa e mësipërme është përcaktuar sipas Nenit 76 të Ligjit Nr.162/2020 “Për Prokurimin Publik”; Kreut V, Seksioni III, Nenin 43, pika 6 të VKM-së Nr.285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik” si dhe sipas Ligjit Nr.9632, datë 30.10.2006 “Për Sistemin e Taksave Vendore” (i ndryshuar). Duke qenë se Autoriteti Kontraktor, Bashkia Kamëz, është njësi e vetëqeverisjes vendore, e cila funksionon dhe ka kompetenca të përcaktuara sipas Ligjit Nr. 139/2015 “Për vetëqeverisjen vendore”, Njësia e Prokurimit argumenton se pika 3 është vendosur në kuadër të Ligjit Nr.9632, datë 30.10.2006 “Për sistemin e Taksave Vendore” (i ndryshuar), Neni 5, gërma “c” ku citohet se: “...përcakton numrin e kësteve të pagimit të taksës dhe afatet e kryerjes së tyre, si dhe kushtet lehtësuese në rastet e pagesës së plotë dhe përpara afateve të detyrimeve fiskale”.

2.3.Përsa i përket aftësisë teknike e profesionale, Operatori Ekonomik duhet të përmbushë kërkesat e mëposhtme minimale të cilat vendosen nga Autoriteti Kontraktor si më poshtë:

2.3.1.Përvojë e suksesshme në realizimin e të paktën:

- a. Punë të ngjashme për një objekt të vetëm me vlerë **jo me te vogel** se **50%** e vlerës së përlllogaritur të kontratës që prokurohet të realizuar gjatë pesë viteve të fundit nga data eshpalljes së njoftimit të kontrates.
- b. Punë të ngjashme deri në një kufi ku vlera monetare totale e punëve të kryera e marrë sëbashku gjatë pesë viteve të fundit është në një vlerë **jo me te vogel** se sa dyfishi i vlerës limit të kontratës që prokurohet konkretisht lekë pa TVSH.

Plotësimi i njerit prej dy kushteve të sipërpermendura e ben oferten të kualifikueshme.

Pika 1/a plotësohet nga anëtari i cili ka përqindjen më të madhe të pjesëmarrjes në bashkim. Anëtarët e tjerë të bashkimit do të paraqesin kontratat e ngjashme në raport me përqindjen e pjesëmarrjes së tyre në bashkim. Kurse pika 1/b duhet të plotësohet nga të gjithë anëtarët e bashkimit në raport me përqindjen e pjesëmarrjes së tyre në bashkim.

Në rastin kur Operatorët ekonomik, anëtarë të një bashkimi, kanë të njëjtën përqindje pjesëmarrjeje në bashkim, vendosin me marrëveshje në Kontratën e Bashkëpunimit se cili prej tyre do ta përmbushë këtë kusht.

2.3.2Vlerësimi i përvojes së suksesshme të Operatorit Ekonomik do të kryhet bazuar nëdeklaratat e dokumentat e mëposhtme:

- a) Për kontrata të realizuara me ente publike, operatori ekonomik duhet të paraqesëdokumentacionin e mëposhtëm:
 - Formular vlerësimi për realizimin e punimeve sipas shtojcës Nr. 9 (ku të përcaktohetqartazi vlera, afati i perfundimit të kontrates si dhe natyra e punës së kryer);
 - Kontratë Sipërmarrje;
 - Situacionin përfundimtar;
 - Aktin e kolaudimit;

- Çertifikaten e marrjes ne dorezim/Çertifikatën e Përkohshme të marrjes ne dorezim
 - Faturë tatimore
- b) Për kontrata të realizuara me sektorin privat, operatori ekonomik duhet të paraqesë dokumentacionin e mëposhtëm:**
- Formular vlerësimi per realizimin e punimeve sipas shtojcës Nr. 9 (ku të përcaktohet qartazi vlera, afati i perfundimit te kontrates si dhe natyra e punes se kryer);
 - Kontrate Sipërmarrje;
 - Situacionin përfundimtar;
 - Aktin e kolaudimit;
 - Çertifikaten e marrjes ne dorezim/ Çertifikatën e Përkohshme të marrjes ne dorezim;
 - Fatura tatimore perkatese.

Argumentimi: Përvoja e sukseshme si dhe vlerësimi i saj u hartua duke iu referuar Nenit 77, pika 4 të Ligjit Nr. 162, datë 23.12.2020 “Për Prokurimin Publik” si dhe bazuar ne Nenin 39, pika 5, të VKM Nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të Prokurimit Publik”. Me anë të këtij kriteri kërkohet që Operatorët ekonomikë të dëshmojnë që kanë përvojën e nevojshme për të zbatuar kontratën, prandaj është kërkuar që:

Përvojë e sukseshme në realizimin e të paktën:

- a) Punë të ngjashme për një objekt të vetëm me vlerë **jo me te vogel** se **50%** e vlerës së përlogaritur të kontratës që prokurohet të realizuar gjatë pesë viteve të fundit nga data eshpalljes se njoftimit te kontrates.
- b) Punë të ngjashme deri ne nje kufi ku vlera monetare totale e punëve të kryera e marrë sëbashku gjatë pesë viteve të fundit është në një vlerë **jo me te vogel** se sa dyfishi i vlerës limit të kontratës që prokurohet konkretisht lekë pa TVSH.

Plotesimi i njerit prej dy kushteve te siperpermendura e ben oferten te kualifikueshme.

Pika 1/a plotësohet nga anëtari i cili ka përqindjen më të madhe të pjesëmarrjes në bashkim. Anëtarët e tjerë të bashkimit do të paraqesin kontratat e ngjashme në raport me përqindjen e pjesëmarrjes së tyre në bashkim. Kurse pika 1/b duhet të plotësohet nga të gjithë anëtarët e bashkimit në raport me përqindjen e pjesëmarrjes së tyre në bashkim.

Në rastin kur Operatorët ekonomik, anëtarë të një bashkimi, kanë të njëjtën përqindje pjesëmarrjeje në bashkim, vendosin me marrëveshje në Kontratën e Bashkëpunimit se cili prej tyre do ta përmbushë këtë kusht.

Gjithashtu referuar VKM-së Nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të Prokurimit Publik”, Kreu XI, Neni 88, pika 3 citohet se: *”Kur oferta paraqitet nga një bashkim operatorësh, kushti i përcaktuar në shkronjën “a”, të pikës 5, të nenit 39, të këtyre rregullave, plotësohet nga anëtari, i cili ka përqindjen më të madhe të pjesëmarrjes në bashkim. Anëtarët e tjerë të bashkimit do të paraqesin kontrata të ngjashme, në raport me përqindjen e pjesëmarrjes së tyre në bashkim. Në rastin kur operatorët ekonomikë, anëtarë të një bashkimi, kanë të njëjtën përqindje pjesëmarrjeje në bashkim, vendosin me marrëveshje në kontratën e bashkëpunimit se cila prej tyre do të përmbushë këtë kusht.”* AK argumenton se Puna e ngjashme është kërkesë, e cila shërben për të vlerësuar përvojën e duhur të Ofertuesve. Vlerësimi i përvojës realizohet duke paraqitur dokumentat e kërkuara sipas pikava (1.2), të cilat vërtetojnë eksperiencën në realizimin e punëve publike të ngjashme, si dhe janë një garanci më shumë për Autoritetin Kontraktor me qëllim përmbushjen me sukses të kontratës objekt prokurimi.

Përvoja e sukseshme si dhe vlerësimi i saj është hartuar duke iu referuar Nenit 77, pika 4 të Ligjit Nr. 162, datë 23.12.2020 “Për Prokurimin Publik” ku qartazi përcaktohet se: *”Në lidhje me aftësitë teknike dhe profesionale, autoritetet ose entet kontraktore mund të vendosin kërkesa që garantojnë*

se operatorët ekonomikë zotërojnë burimet e nevojshme njerëzore e teknike, si dhe përvojën e nevojshme për të zbatuar kontratën sipas një standardi të përshtatshëm cilësie.

Autoritetet ose entet kontraktore, në veçanti, mund të kërkojnë që operatorët ekonomikë të kenë një nivel të mjaftueshëm përvoja që vërtetohet nga referenca të përshtatshme nga kontratat e zbatuara në të shkuarën.

Aftësia profesionale e operatorëve ekonomikë për të ofruar shërbimin, punën, mallin vlerësohet në lidhje me aftësitë organizative, reputacionin dhe besueshmërinë, përvojën e duhur, si dhe personelin e nevojshëm për të zbatuar kontratën, siç është përshkruar nga autoriteti ose enti kontraktor në njoftimin e objektit të kontratës.”, si dhe bazuar në Nenin 39, pika 5, të VKM Nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të Prokurimit Publik”, ku përcaktohet se: ”Për të provuar përvojën e mëparshme, autoriteti/enti kontraktor kërkon: a) punë të ngjashme për një objekt të vetëm në një vlerë jo më të madhe se 50% e vlerës së përllogaritur të kontratës që prokurohet dhe që është realizuar gjatë pesë viteve të fundit, nga data e shpalljes së njoftimit të kontratës; b) punë të ngjashme deri në një kufi, ku vlera monetare totale e punëve të kryera, e marrë së bashku gjatë pesë viteve të fundit, është jo më e madhe se dyfishi i vlerës limit të kontratës që prokurohet. Plotësimi i njërës prej dy kushteve të sipërpërmendura e bën ofertën të kualifikueshme. Autoriteti/enti kontraktor, si dëshmi për përvojën e mëparshme, kërkon vërtetime të lëshuara nga një ent publik, për përmbushjen me sukses të kontratës, ku të shënohen vlera, afati i përfundimit të kontratës dhe natyra e punës së bërë, për të vërtetuar përmbushjen e suksesshme të punëve. Në rastin e përvojës së mëparshme të realizuar me sektorin privat, autoriteti/enti kontraktor kërkon si dëshmi, vërtetime, për përmbushjen me sukses të kontratës, ku të shënohen vlera, afati i përfundimit të kontratës dhe natyra e punës së bërë, e shoqëruar me fatura tatimore dhe çdo lloj dokumenti tjetër, që parashikohet nga legjislacioni në fuqi, që provon realizimin me sukses të punëve.”.

Njesia e Prokurimit argumenton se Puna e ngjashme është kërkesë, e cila shërben për të vlerësuar përvojën e duhur të Ofertuesve. Vlerësimi i përvojës realizohet duke paraqitur dokumentat e kërkuara sipas pikave 1.3 të cilat vërtetojnë eksperiencën në realizimin e punëve publike të ngjashme, si dhe janë një garanci më shumë për Autoritetin Kontraktor me qëllim përmbushjen me sukses të kontratës objekt prokurimi. Nga praktika, gjatë fazes së vlerësimit të ofertave, është konstatuar se Komisionet e Vlerësimit të Ofertave kanë hasur vështirësi në vlerësimin në mënyrë sa më të drejtë të përvojës së ngjashme, në rastet kur në formularet e vlerësimit nuk përcaktohen % e pjesëmarrjes të secilit operator bashkim, pasi jo të gjitha institucionet shtetërore apo private leshojnë Formularin e Vlerësimit sipas formatit zyrtar (ku përcaktohet ndarja e përqindjeve), për rrjedhojë është e domosdoshme që Operatorët Ekonomikë kur paraqesin kontrata të ngjashme, ku janë pjesë e një bashkimi operatorësh duhet të paraqesin gjithashtu dhe marrëveshjen e bashkëpunimit dhe prokurën e posaçme ku të përcaktohen % përkatëse.

2.3.3.Liçensa profesionale, lidhur me ekzekutimin e punëve të kontratës:

Operatori Ekonomik duhet të disponojë Liçencë të shoqërisë e vlefshme për kategoritë e mëposhtme:

Operatori Ekonomik duhet të disponojë Liçencë të shoqërisë e vlefshme për kategoritë emëposhtme:

1. NP– 1 A Punime gjurmimi në tokë.
2. NP– 4 B Rrugë, autostrada, ura, mbikalime, hekurudha, linja tramvaji, metro, hekurudhë me kavo dhe pista aeroportuale.
3. NP- 7 A Ujesjellesa, gazsjellesa, vajsjellesa, vepra kullimi e vaditje
4. NP– 11 A Ndërtime për nënstacionet, kabinat e transformatorëve, linja e tensionit të lartë e të mesëm dhe shpërndarjen e energjisë.

5. NP– 12 **B** Punime të inxhinierisë së mjedisit.

6. NS- 18 **A** Punime topogjeodezike.

Argumentimi: Kërkesa e mësipërme është përcaktuar bazuar në Nenin 77, pika 1 të Ligjit Nr. 162, datë 23.12.2020 “Për Prokurimin Publik”; Kreut V, Seksioni III, Neni 39, pika 6/a, të VKM Nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik”, si dhe mbështetur në Vendimin e Keshillit të Ministrave Nr. 42 datë 16.01.2008 “Për miratimin e rregullores për kriteret dhe procedurat e dhënies së licencave profesionale të zbatimit, klasifikimit dhe disiplinimit të subjekteve juridike që ushtrojnë veprimtari ndërtimi”. Referuar kategorive të kërkuara, AK argumenton teknikisht se kjo kërkesë është vendosur sipas zërave të preventivit të punimeve.

Për sa më lart, me qëllim realizimin e punës objekt prokurimi, është kërkuar që Ofertuesit të jenë të pajisur me Licencë profesionale për kategoritë, të cilat janë vendosur sipas volumeve të punimeve dhe vlerave që përmban Preventivi për cdo zë pune mbështetur në Vendimin e Këshillit të Ministrave Nr. 42, datë 16.1.2008 “Për miratimin e rregullores për kriteret dhe procedurat e dhënies së licencave profesionale të zbatimit, klasifikimit dhe disiplinimit të subjekteve juridike, që ushtrojnë veprimtari ndërtimi”, ku janë përcaktuar kategoritë dhe nënkategoritë përkatëse. Kjo kërkesë është vendosur nga Autoriteti Kontraktor me qëllim shqyrtimin e kualifikimit profesional të Ofertuesve në kuadër të veprimtarisë tregtare objekt prokurimi.

Kategoria e kërkuar	Pershkrimi i kategorisë sipas legjislacionit të fushës	Zërat e punimeve që parashikohen të kryhen në preventiv, që përfshihen në kategorinë përkatëse	Niveli i klasifikimit i kërkuar për kategorinë respektive					
NP-1 A	Punime germimi ne toke	<table border="1"> <tr> <td style="text-align: center;"><u>Kategoria Punimeve</u></td> </tr> <tr> <td style="text-align: center;"><i>Punime Germimi</i></td> </tr> </table>	<u>Kategoria Punimeve</u>	<i>Punime Germimi</i>	<p>0-20 milion</p> <p>Vlera e parashikuar ne preventive per kete kategori punimesh eshte rreth 1,518,318 leke</p>			
<u>Kategoria Punimeve</u>								
<i>Punime Germimi</i>								
NP-4 B	Rrugë, autostrada, ura, mbikalime, hekurudha, linja tramvaji, metro, hekurudhë me kavo dhe pista aeroportuale.	<table border="1"> <tr> <td style="text-align: center;"><u>Kategoria Punimeve</u></td> </tr> <tr> <td style="text-align: center;"><i>Punime per sheshin</i></td> </tr> <tr> <td style="text-align: center;"><i>Punime Murature</i></td> </tr> <tr> <td style="text-align: center;"><i>Punime Shtresash</i></td> </tr> <tr> <td style="text-align: center;"><i>Punime te Ndryshme</i></td> </tr> </table>	<u>Kategoria Punimeve</u>	<i>Punime per sheshin</i>	<i>Punime Murature</i>	<i>Punime Shtresash</i>	<i>Punime te Ndryshme</i>	<p>20-50 milion</p> <p>Vlera e parashikuar ne preventiv per kete kategori punimesh eshte rreth 45,833,333 leke pa tvsh</p>
<u>Kategoria Punimeve</u>								
<i>Punime per sheshin</i>								
<i>Punime Murature</i>								
<i>Punime Shtresash</i>								
<i>Punime te Ndryshme</i>								
NP-7 A	(Ujësjellës, kanalizime, vepra kullimi e vaditje)	<table border="1"> <tr> <td style="text-align: center;"><u>Kategoria Punimeve</u></td> </tr> <tr> <td style="text-align: center;"><i>Punime KUB</i></td> </tr> <tr> <td style="text-align: center;"><i>Sistemi I furnizimit me uje te pishem</i></td> </tr> </table>	<u>Kategoria Punimeve</u>	<i>Punime KUB</i>	<i>Sistemi I furnizimit me uje te pishem</i>	<p>0-20 milion</p> <p>Vlera e parashikuar ne preventiv per kete kategori punimesh eshte rreth 4,145,284.7 Leke</p>		
<u>Kategoria Punimeve</u>								
<i>Punime KUB</i>								
<i>Sistemi I furnizimit me uje te pishem</i>								
NP-11 A	Ndertime per N/stacionet,kabinat e transformatoreve linja TN e te mesem dhe shperndarjen e energjise	<table border="1"> <tr> <td style="text-align: center;"><u>Kategoria Punimeve</u></td> </tr> <tr> <td style="text-align: center;"><i>Shtylla, Kabina elektrike</i></td> </tr> </table>	<u>Kategoria Punimeve</u>	<i>Shtylla, Kabina elektrike</i>	<p>0-20 milion</p> <p>Vlera e parashikuar ne preventiv per kete kategori punimesh eshte rreth 6,998,430 Leke</p>			
<u>Kategoria Punimeve</u>								
<i>Shtylla, Kabina elektrike</i>								

NP-12 A	Punime te Inxhinierise Mjedisore	<p style="text-align: center;"><u>Kategoria Punimeve</u></p> <p style="text-align: center;"><i>Punime Gjelberimi</i></p>	<p>0-20 milion</p> <p>Vlera e parashikuar ne preventiv per kete kategori punimesh 1,151,353 Leke</p>
NS-18 A	Punime Topogjeodozike	<p style="text-align: center;"><u>Kategoria Punimeve</u></p> <p style="text-align: center;"><i>Punime topografike ne matje dhe rilevime per realizimin e objektit I dhe kerkohet anagazhim me pajisje dhe staf te specializuar per realizimin e rilevimeve topografike</i></p>	

N.P-1A (Punime gërmimi në tokë)

Në Preventivin e punimeve për procedurën objekt prokurimi ka zëra pune që lidhen me gërmime në tokë, ndaj është e nevojshme që Operatori ekonomik që do të shpallet fitues të jetë i licensuar me qëllim përmbushjen e kontratës me sukses.

N.P-4 B (Rrugë, autostrada, mbikalime, hekurudha, tramvai, metro, pista aeroportuale)

Duke marrë në konsideratë objektin e prokurimit, i cili lidhet me ndërtimin e rikualifikimin urban te rruges, është e nevojshme që Operatori ekonomik të jetë i licensuar për keto punime , të cilat bëjnë pjesë në kategorinë rrugë.

NP– 7 A (Ujësjellës, kanalizime, vepra kullimi e vaditje)

Në Preventivin e punimeve për procedurën objekt prokurimi ka zëra pune që lidhen me punime ne rrjetin e kanalizimeve, ndaj është e nevojshme që Operatori ekonomik që do të shpallet fitues të jetë i licensuar me qëllim përmbushjen e kontratës me sukses.

NP– 11 A (Ndërtime për nënstacionet, kabinat e transformatorëve, linja e tensionit të lartë e të mesëm dhe shpërndarjen e energjisë)

Në Preventivin e punimeve për procedurën objekt prokurimi ka zëra pune që lidhen me punime që lidhen me punime per ndertimin e ndriçimit rrugor, ndaj është e nevojshme që Operatori ekonomik që do të shpallet fitues të jetë i licensuar me qëllim përmbushjen e kontratës me sukses.

NP– 12 A Punime të inxhinierisë së mjedisit.

Në Preventivin e punimeve për procedurën objekt prokurimi ka zëra pune që lidhen me punime që lidhen me punime per mbjellje peme decorative , ndaj është e nevojshme që Operatori ekonomik që do të shpallet fitues të jetë i licensuar me qëllim përmbushjen e kontratës me sukses

NS-18A (Punime topogjeodezike)

Duke qene se në projekt e preventiv janë parashikuar punime të natyrës topogjeodezike (Matjet, piketimi, punimet ne trupin e rruges është e nevojshme zotërimi i kësaj pike license.

Klasifikimi i shoqërive ndërtimore sipas niveleve për çdo kategori punimesh zbatimi i referohet Vendimit të Keshillit të Ministrave Nr.42 datë 16.01.2008 “Për miratimin e rregullores për kriteret dhe procedurat e

dhënies së licencave profesionale të zbatimit, klasifikimit dhe disiplinimit të subjekteve juridike që ushtrojnë veprimtari ndërtimi”.

2.3.4. Operatori ekonomik duhet të paraqesë licensë III.2.B per “Grumbullim, dhe transportim i mbetjeve inerte dhe urbane jo te rrezikshme”,

Argumentimi: Kërkesa e mësipërme është përcaktuar bazuar në Nenin 77, pika 1 të Ligjit Nr. 162, datë 23.12.2020 “Për Prokurimin Publik”; Kreut V, Seksioni III, Neni 39, pika 6/a, të VKM Nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik”, Ligji nr.10081, datë 23.2.2009 “Për licencat, autorizimet dhe lejet në Republikën e Shqipërisë” të ndryshuar dhe në VKM nr. 538 datë 26.5.2009 “Për licencat dhe lejet që trajtohen nga apo nëpërmjet Qendrës Kombëtare të Licencimit dhe disa rregullimeve të tjera nënligjore të përbashkëta” të ndryshuar.

Operatori ekonomik fitues gjatë fazës së zbatimit të punimeve duhet të raportojë pranë autoritetit kontraktor për masat e marra për mbrojtjen e mjedisit nga ndikimet negative të veprimtarisë, për këtë qëllim subjekti duhet të jetë i licencuar për vlerësimin e ndikimit në mjedis në përputhje me detyrimet ligjore që rrjedhin nga ky i fundit për raportimin pranë autoritetit kontraktues.

Rregullat dhe procedurat e përgjithshme për garantimin e mbrojtjes në një nivel të lartë të mjedisit janë detyrim ligjor për çdo subjekt tregtar person fizik apo juridik për parandalimin dhe pakësimin e rreziqeve ndaj jetës e shëndetit të njeriut, sigurimin dhe përmirësimin e cilësisë së jetës, në dobi të brezave të sotëm dhe të ardhshëm, si dhe sigurimin e kushteve për zhvillimin e qëndrueshëm të vendit. Garantimi i ekspertizës së mbrojtjes së mjedisit në punë dhe dokumentat përkatëse të operatoreve i shërbejnë autoritetit për të krijuar bindjen dhe besueshmëri për realizimin e kontratës.

2.3.5. Operatori ekonomik për realizimin e punimeve duhet të disponojë fuqi punetore minimalisht **45 (dyzet e pese)** personave/personave. Për përmbushjen e këtij kriteri, operatori ekonomik duhet të vetedeklarojë disponimin e numrit minimal të punonjesve, për periudhën **Korrik 2022 - Shtator 2022**, në formularin përmbledhës të vetedeklarimit, sipas shtojcës 8. Ndërsa operatori ekonomik i kualifikuar dhe i renditur i pari pas vlerësimit të ofertave, duhet të dorëzojë dokumentacionin si më poshtë:

a. Vertetim të leshuar nga Sigurimet Shoqërore ose Administrata Tatimore sipas formatit që kërkohej nga legjislacioni në fuqi ku të specifikohet numri i punonjesve për secilin muaj, për periudhën **Korrik 2022 - Shtator 2022**.

b. Listepagesat e punonjesve sipas formatit që kërkohej nga legjislacioni në fuqi për periudhën **Korrik 2022 - Shtator 2022**

Kriteri konsiderohet i përmbushur me paraqitjen e formularit të vetëdeklarimit sipas shtojcës 8. Operatori ekonomik i kualifikuar dhe i renditur i pari pas vlerësimit të ofertave, duhet të dorëzojë dokumentacionin provues për pikat 2.3.5/a dhe 2.3.5/b

Argumentimi: Autoriteti Kontraktor këtë kriter e ka bazuar në nenin 77, pika 4 të Ligjit nr.162 datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik” në të cilin thuhet: “Aftësia profesionale e operatorëve ekonomikë për të ofruar shërbimin, punën, mallin vlerësohet në lidhje me aftësitë organizative, reputacionin dhe besueshmërinë, përvojën e duhur, si dhe personelin e nevojshëm për të zbatuar kontratën, siç është përshkruar nga autoriteti ose enti kontraktor në njoftimin e objektit të kontratës”.

Numri i punonjësve është përcaktuar bazuar në afatin, orët e punës dhe pagën minimale të lejuar, që duhen për të përmbushur zbatimin e kontratës. Numri i punonjësve dhe qëndrueshmëria e tyre në punë me kohështrirje **Korrik 2022 - Shtator 2022.**, tregon besueshmëri për autoritetin. Dëshmia e kërkuar për numrin e fuqisë punëtore të operatorit ekonomik e nevojshme për ekzekutimin e objektit të kontratës, është dokument që vërteton kapacitetin teknik dhe profesional të operatorit, për sa kohë që ato janë në përpjesëtim me natyrën dhe përmasat e kontratës. Deklarimi dhe regjistrimi i punonjësve në regjistrin e sigurimeve është një detyrim ligjor i punëdhënësit e parashikuar nga Kodi i Punës, për rrjedhojë çdo dëshmi me këtë kohështrirje është dokument vërtetues për qëndrueshmërinë e të punësuarve dhe përvojën e tyre, për sa kohë që ato janë në përpjesëtim me natyrën dhe përmasat e kontratës. Punësimi i një numri të caktuar, si një nga kërkesat themelore të kualifikimit, përveç besueshmërisë së operatorëve ekonomik, përpiket të kufizojë edhe problematikat sociale dhe shmangien e informalitetit në tregun e punës, po ashtu është një tregues i kualifikimit dhe eksperiencës që duhet të ketë kjo kategori e punonjësve. Vendosja e kriterit për një punësim **te paktën 45 (dyzet e pese)** personave duke përfshirë dhe stafin teknik, është në përputhje me volumin e punës, natyrën dhe terrenin ku do të kryhen punimet. Po t'i referohemi projektit, preventivit, relacionit, matjeve përkatëse që ka bërë projektuesi është plotësisht i justifikuar numri i punonjësve. Kriteri për kualifikim është vendosur që t'i shërbejë autoritetit për të njohur gjendjen e kapaciteteve të operatorëve të cilët nëpërmjet dokumentacionit të vërtetojnë se zotërojnë, kapacitetet teknike dhe profesionale, personelin e nevojshëm, si dhe kapacitetet organizative, gjithçka në funksion të realizimit me sukses të kontratës.

Analizat teknike janë bazuar në VKM nr. 629, datë 15.7.2015 “Për miratimin e manualeve teknike të çmimeve të punimeve të ndërtimit dhe të analizave teknike të tyre” (Ndryshuar me VKM nr. 631, datë 26.10.2018). Bazuar në kater elementet e struktues se koston (material, puntori, makineri, transport) zeri fuqi puntore ze rreth 20% te koston.

2.3.6. Operatorët ekonomik pjesëmarrës duhet të kenë të punësuar staf inxhinierik për kryerje në të gjitha punimeve në objekt, të përfshirë në licensën e shoqërisë, të vërtetuar me kontratë pune të vlefshme, librezë pune, diplomë përkatëse si dhe të figurojnë në listpagesat e shoqërisë minimumi për periudhën **Korrik 2022 - Shtator 2022.**

- 1 (një) Inxhinier Ndertimi
- 1 (një) Inxhinier Hidroteknik
- 1 (një) Inxhinier Elektrik
- 1 (një) Inxhinier Gjeodet /Topograf/,
- 1 (një) Inxhinier Mjedisi

Kriteri konsiderohet i përmbushur me paraqitjen e formularit të vetëdeklarimit sipas shtojcës 8. Operatori ekonomik i kualifikuar dhe i renditur i pari pas vleresimit të ofertave, duhet të dorëzojë dokumentacionin e kërkuar për inxhinieret e mesiperm.

Argumentimi: Autoriteti Kontraktor argumenton se kërkesa për stafin inxhinierik është vendosur sipas përcaktimeve të Ligjit Nr. 162, datë 23.12.2020 “Për Prokurimin Publik”, Neni 77, pika 4, si dhe në VKM Nr. 285 datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, Kreu V, Seksioni III, Neni 39, pika 6, gërma “c”.

Kriteri për stafin staf inxhinierik, lidhet ngushtësisht me objektin e kontrates, relacionin teknik dhe zërat e punimeve. Nevoja për inxhinierët në objekt është e diktuar nga përvoja dhe legjislacioni për punimet e ndërtimit. Mungesa e këtij stafi pothuajse në çdo rast rezulton në realizim jashtë afatit, jashtë normave dhe me cilësi të dobët të punimeve. Numri i stafit kryesor teknik si numri i inxhinierit të ndërtimit, hidroteknik, elektrik, gjeodet, mjedisi, është përcaktuar nga pikëpamja e natyrës teknike të kontratës me qëllimin për të patur një rezultat sa më të mirë në mbarëvajtjen dhe zbatimin e punimeve. Operatorët ekonomikë duhet të vërtetojnë se zotërojnë kualifikimet e nevojshme teknike,

profesionale, kapacitetet organizative, reputacionin dhe besueshmërinë, përvojën e duhur, si dhe personelin e nevojshëm, për të zbatuar kontratën. Drejtuesi i teknik është përgjegjës për ndërtimin në përputhje me kushtet teknike të zbatimit, sigurimin teknik dhe mbrojtjen në punë brenda kushteve të kontratës. Bazuar në parashikimet e mësipërme të legjislacionit për prokurimin publik, Autoriteti Kontraktor ka kërkuar që operatori ekonomik ofertues duhet të ketë në stafin e tij **drejtues teknik** cilët kanë një rol të rëndësishëm në mbarëvajtjen e punimeve pasi ata janë përgjegjës për zbatimin e objektit sipas projektit dhe në përputhje me kushtet teknike të zbatimit të tij.

Kërkesa specifike për Inxhinierët e kërkuar është përcaktuar në kuadër të analizës teknike që i është bërë Preventivit të Punimeve (nga ku përcaktohet qartazi dhe profili inxhinierik) si dhe në bashkerendim me kategoritë e kërkuara në Licencën profesionale të shoqërisë sipas pikës 2.3.3, kapaciteti teknik në DST. Duke marrë në konsideratë Projektin e zbatimit si dhe Preventivin e Punimeve rezulton se është e domosdoshme që çdo Ofertues të ketë pjesë të stafit Inxhinierë të kërkuar sipas pikës 2.3.4, të cilët në bashkëpunim me njëri tjetrin ,stafin mbeshtetes si dhe me fuqinë punëtore të shoqërisë do të realizojnë me sukses kontratën objekt prokurimi.

- Referuar në preventivin e Punimeve si dhe në bashkerendim me kategoritë e kërkuara në Licencën profesionale të shoqërisë sipas pikës **NP - 1, NP - 2**, eshte e nevojshme prezenca e **Inxhinierit të Ndërtimit**..
- Referuar në preventivin e Punimeve si dhe në bashkerendim me kategoritë e kërkuara në Licencën profesionale të shoqërisë sipas pikës **NP - 7**, eshte e nevojshme prezenca e **Inxhinierit Hidroteknik**. Ne kete veper parashikohen nderhyrje te konsiderueshme ne ndertimin e impianteve sanitare dhe mbrojtjes nga zjarri.
- Referuar në preventivin e Punimeve si dhe në bashkerendim me kategoritë e kërkuara në Licencën profesionale të shoqërisë sipas pikës **NP - 11**, eshte e nevojshme prezenca e **Inxhinierit Elektrik**. Ne kete veper nje pjese te rendesishme zene punimet per instalimet elektrike.
- Referuar në preventivin e Punimeve si dhe në bashkerendim me kategoritë e kërkuara në Licencën profesionale të shoqërisë sipas pikës **NS 18** eshte e nevojshme prezenca e një **Inxhinier Gjeodet/Topograf/**, pasi çdo matje që do të bëhet në funksion të objektit të prokurimit kërkon domosdoshmërisht praninë e këtij Inxhinieri.
- Referuar në preventivin e Punimeve si dhe në bashkerendim me kategoritë e kërkuara në Licencën profesionale të shoqërisë sipas pikës **NP - 1, NP - 12** eshte e nevojshme prezenca e **Inxhinier Mjedis**. Ne kete veper parashikohen volume gemimi te cilat kane ndikim te drejtperdrejt dhe ne mjedisin perreth duke qene se vepra realizohet ne zone mjaft te populluar, si dhe gjithashtu kemi parashikuar punime gjelberimi dhe mbjellje pemesh.

2.3.7.Operatori ekonomik, për realizimin e punimeve ne objektin e kontrate, duhet të disponojë edhe punonjes te specializuar/kualifikuar me arsim te lart dhe te mesem, specialistet te shoqerohen me kontrata pune, te figurojne ne listepagese, si me poshte:

- 1(nje) Inxhinier Ndertimi,
- 2(dy) Teknik Ndertimi
- 1 (nje) Teknik Gjeodet/Topograf
- 1 (nje) Hidraulik
- 1 (nje) Agronom

Argumentimi: Kjo kërkesë mbështetet në Ligjin Nr. 162, datë 23.12.2020 “Për Prokurimin Publik”, Neni 77, pika 4; në VKM Nr. 285 datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, Kreu V, Seksioni III, Neni 39, pika 6, gërma “c”.

Kërkesa specifike për punonjesit e kërkuar me lart sipas pikës 7, është përcaktuar në kuadër të analizës teknike që i është bërë Preventivit të Punimeve, nga ku përcaktohet profili inxhinierik i nevojshëm për ekzekutimin e kontratës si dhe në bashkrendim me kategoritë e kërkuara në Licencën profesionale të shoqërisë sipas pikës 2, kapaciteti teknik në DST.

2.3.8. Operatori ekonomik ofertues duhet disponojë punonjës të specializuar/ kualifikuar dhe duhet të figurojë në listpagesat e shoqërisë për periudhën **Korrik 2022 - Shtator 2022** si më poshtë:

- Operatorët ekonomik të kenë në stafin e tyre **1 (një)** inxhinier të pajisur me çertifikatë “Përgjegjës për sigurinë dhe mbrojtjen e shëndetit në punë”, në përputhje me klauzolat e ligjit Nr. 10327, datë 18.02.2010 “Për sigurinë dhe shëndetin në punë” dhe V.K.M-së Nr. 312, datë 05.05.2010 “Për miratimin e rregullores për sigurinë në kantier”. Për këtë duhet të paraqitet çertifikata e trajnimit për “Përgjegjës për sigurinë dhe mbrojtjen e shëndetit në punë”, e dhënë nga një organizem i licensuar, shqiptar ose i huaj dhe kontrate pune.
- Operatorët ekonomik të kenë **1 (një)** mjek të përgjithshëm i cili të jetë i licensuar për ushtrim profesional sipas urdherit të mjekut shoqëruar me diplomë përkatëse, Licensë ushtrim profesionali përkatëse dhe kontrate pune.

Argumentimi: AK argumenton se kërkesa për *Përgjegjës për sigurinë dhe mbrojtjen e shëndetit në punë* është vendosur sipas përcaktimeve të Ligjit Nr. 162, datë 23.12.2020 “Për Prokurimin Publik”, Neni 77, pika 4; të VKM-së Nr. 285 datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, Kreu V, Seksioni III, Neni 39, pika 6, gërma “c”, si dhe në mbështetje të Nenit 7 të Ligjit Nr. 10237, datë 18.02.2010, “Për sigurinë dhe shëndetin në punë“, sipas të cilit: „Punëdhënësi ngarkon një ose disa punëmarës që të merren me çështjet e mbrojtjes, të sigurisë e shëndetit në punë.....“.

Theksojmë se, Autoriteti Kontraktor ka qëllim realizimin e kontratës objekt prokurimi sipas kushteve të përcaktuara në DST, duke respektuar çdo rregull lidhur me kantierin e ndërtimit si dhe me sigurinë e punonjësve gjatë ushtrimit të veprimtarisë së punës. Është e rëndësishme që punimet të realizohen brenda një kantieri të sigurt duke mbrojtur jetën e punonjësve, por dhe të kalimtarëve që mund të jenë përreth vendit të punimeve. Për sa më lart, punonjësi i cili është i çertifikuar si "Përgjegjës për sigurinë dhe mbrojtjen e shëndetit në punë", nëpërmjet dijes dhe eksperiencës të fituar në këtë fushë, duhet të shmangë apo parandalojë çdo rrezik që mund të shfaqet gjatë veprimtarisë së shoqërisë dhe që mund të çenojë shëndetin apo sigurinë në punë. Në këto kushte, vendosja e këtij kriteri shërben si një garanci që Ofertuesit do të realizojnë punimet sipas standarteve ligjore në fuqi.

2.3.8. Operatori ekonomik, për realizimin e punimeve objekt kontrate, duhet të disponojë edhe punonjes të specializuar/kualifikuar si më poshtë:

1 (një) punonjes i pajisur me çertifikuar “Përgjegjës për sigurinë dhe mbrojtjen e shëndetit në punë” e cila të jete e leshuar nga shoqëri të akredituara ose nga organizma ndërkombetare akreditues të njohur nga Republika e Shqipërisë.

Kriteri konsiderohet i përmbushur në paraqitjen në formularin e vetedeklarimit. Operatori ekonomik i kualifikuar dhe i renditur i pari pas vlerësimit të ofertave përpara shpalljes së njoftimit të fituesit duhet të paraqesë dokumentacionin e mëposhtëm për punonjesit e mesipër përpara lidhjes së kontratës, të paraqitet kontrata e punës, dhe diploma ose çertifikata e kërkuar.

Argumentimi: AK argumenton se kërkesa për **1 (një)** mjek të përgjithshëm është vendosur sipas përcaktimeve të Ligjit Nr. 162, datë 23.12.2020 “Për Prokurimin Publik”, Neni 77, pika 4; të VKM-së Nr. 285 datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, Kreu V, Seksioni III, Neni 39, pika 6, gërma “c”, si dhe në baze Vendimit Nr. 632, datë 15.7.2015 “Për disa ndryshime

dhe shtesa në Vendimin Nr. 108, datë 9.2.2011, të Këshillit të Ministrave, “Për aftësitë që duhet të plotësojnë punëmarrësit, personat dhe shërbimet e specializuara, që merren me çështjet e sigurisë dhe të shëndetit në punë”.

2.3.9 Operatori ekonomik, për realizimin e punimeve objekt kontrate, duhet të disponojë edhepunonjes të specializuar/kualifikuar si me poshte:

- 2 (dy) Murator (Me Certificate Trajnimi / Diplome)**
- 1 (nje) Saldator (Me Certificate Trajnimi / Diplome)**
- 4 (kater) Karpentier (Me Certificate Trajnimi / Diplome)**
- 2 (dy) Elektracist (Me Certificate Trajnimi / Diplome)**
- 2 (dy) Pllakashtrues (Me Certificate Trajnimi / Diplome)**
- 2 (dy) Hidraulik (Me Certificate Trajnimi / Diplome)**
- 2 (dy) Hekurkthyes (Me Certificate Trajnimi / Diplome)**
- 2(dy) Specialist per vendosje bordurash (Me Certificate Trajnimi / Diplome)**
- 5 (pese)Punëtorë ndërtimi dhe profesione të lidhura me to (kontrate pune)**

Per profesionet si me sipër, operatori ekonomik duhet te plotesoje tabelën si me poshtë:

Nr	Emer Mbiemer	Profesioni	Data e fillimit te marredhenieve te punes	Nr. Amzes/ekuivalent t i diplomes/certifikates profesionale	Institucioni/ Subjekti certifikues	Data e vlefshmerise se certifikates profesionale
1						
2						

Për punonjesit e mësipërm të paraqiten kontratat e punes te vlefshme si dhe certifikata/diploma profesionale per secilin. Certifikatat/diplomat duhet te jene te leshuara nga institucione publike/private te licensuara, për kurset e ofruara, sipas ligjitNr. 15/2017 “Per arsimin dhe formimin profesional ne R.Sh.”

Punetoret e mesiperm te figurojne ne listepagesa per periudhen e kerkuar.

- Operatori ekonomik te paraqes deklarate ne lidhje me stafin qe disponon sipas formatit te meposhtem:

Nr	Emer Mbiemer	Profesioni	Data e fillimit marredhenieve punes	Nr. Amzes/ekuivalent diplomes/certifikates profesionale	Institucioni/ Subjekti certifikues	Data vlefshmerise se certifikates profesionale
----	--------------	------------	-------------------------------------	---	------------------------------------	--

Kriteri konsiderohet i përmbushur me paraqitjen e formularit të vetëdeklarimit sipas shtojcës 8 te DST.

Operatori ekonomik i kualifikuar dhe i renditur i pari pas vleresimit te ofertave, duhet te dorezoje dokumentacionin e kerkuar per punetoret e mesiperm.

Argumentimi: Kjo kërkesë mbështetet në Ligjin Nr. 162, datë 23.12.2020 “Për Prokurimin Publik”, Neni 77, pika 4; në VKM Nr. 285 datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, Kreu V, Seksioni III, Neni 39, pika 6, gërma “c”.

Qëllimi i vendosjes së këtij kushti është i implementuar sipas dispozitave ligjore dhe shërben si një garanci që kontrata objekt prokurimi do të realizohet me sukses sipas Specifikimeve Teknike (të cilat do publikohen së bashku me Dokumentat e Tenderit) si dhe punimet do të kryhen brenda afatit kohor të parashikuar në Njoftimin e Kontratës. Sqarojmë se, të gjithë specialistët e kërkuar janë në përputhje të plotë me projekt-preventivin duke marrë në konsideratë volumet e punes qe do te realizohen,si dhe kohëzgjatjen e tyre. Autoriteti Kontraktor domosdoshmërisht duhet të garantohet që këto punime do të kryhen nga persona të kualifikuar dhe me eksperiencë të mjaftueshme, për zbatimin e këtyre punimeve sipas standarteve të percaktuara në specifikimet teknike. Për të vërtetuar kualifikimin e stafit teknik është kërkuar që të jenë të pajisur me diplomë/dëshmi përkatëse lëshuar nga institucione të akredituara nga autoritetet përgjegjëse shtetërore, dëshmi kualifikimi të sigurimit teknik, (të vlefshme) lëshuar nga Inspektoriati Shtetëror Teknik. Certifikimet/diplomat profesionale duhet të jenë të lëshuara nga institucione të licensuara nga organet përkatëse, mbështetur në Ligjin Nr. 15/2017 “PËR ARSIMIN DHE FORMIMIN PROFESIONAL NË REPUBLIKËN E SHQIPËRISË” Mbështetur në këtë legjislacion certifikimet profesionale ofrohen nga institucione të licensuara nga Ministria përkatëse nëpërmjet Agjencise Kombëtare të Arsimit, Formimit Profesional. Certifikatat e këtyre specialisteve duhet të jenë të regjistruara në “rregjistrat profesionale” të AKAFP-se.

Ne lidhje me 2 (dy) punonjes murator kjo kërkesë përputhet me punimet e preventivit si dhe referuar volumeve të punes qe do te realizohen ne baze te analizes teknike.

Ne lidhje me 1 (nje) punonjes saldator kjo kërkesë përputhet me punimet e preventivit si dhe referuar volumeve të punes qe do te realizohen ne baze te analizes teknike.

Ne lidhje me 4 (kater) punonjes karpentier kjo kërkesë përputhet me punimet e preventivit si dhe referuar volumeve të punes qe do te realizohen ne baze te analizes teknike.

Ne lidhje me 2 (dy) punonjes elektriciste kjo kërkesë përputhet me punimet e preventivit si dhe referuar volumeve të punes qe do te realizohen ne baze te analizes teknike.

Ne lidhje me 2 (dy) punonjes Pllakashtrues kjo kërkesë përputhet me punimet e preventivit si dhe referuar volumeve të punes qe do te realizohen ne baze te analizes teknike.

Ne lidhje me 2 (dy) hidraulik kjo kërkesë përputhet me punimet e preventivit si dhe referuar volumeve të punes qe do te realizohen ne baze te analizes teknike.

Ne lidhje me 2 (dy) punonjes hekurkthyes kjo kërkesë përputhet me punimet e preventivit si dhe referuar volumeve të punes qe do te realizohen ne baze te analizes teknike.

Ne lidhje me 2 (dy) Specialist per vendosje bordurash kjo kërkesë përputhet me punimet e preventivit si dhe referuar volumeve të punes qe do te realizohen ne baze te analizes teknike.

Ne lidhje me 5 (pese) Punëtorë ndërtimi kjo kërkesë përputhet me punimet e preventivit si dhe referuar volumeve të punes qe do te realizohen ne baze te analizes teknike

2.3.10. Operatori ekonomik, për realizimin e punimeve objekt kontrate, duhet të disponojë edhe punonjes të specializuar/kualifikuar si me poshte:

5(pesë)	Shofer Kamioni
2 (dy)	Eskavatorist
2 (dy)	Automakinist

Per manovratorët e mjeteve të renda si me sipër të paraqitet kontrate pune e vlefshme, lejet e drejtimit për makinerite të renda sipas profesionit përkatës dhe dëshmi kualifikimi të sigurimit teknik nga ISHTI ose nga institucione ekuivalente.

Per shoferët të paraqitet kontrate pune e vlefshme, lejet e drejtimit dhe dëshmi kualifikimi të sigurimit teknik nga ISHTI ose nga institucione ekuivalente.

Punëtorët e mesipër të figurojnë në listëpagesa për periudhën e kërkuar. ***Në rastin kur punonjësit Manovrator ose shofer janë të kontraktuar me kontratë pune (respektivisht për mjetet e marra me qera), nuk kërkohet të figurojnë në listëpagesat e shoqërisë.***

Kriteri konsiderohet i përmbushur me paraqitjen e formularit të vetëdeklarimit sipas shtojcës 8.

Operatori ekonomik i kualifikuar dhe i renditur i pari pas vleresimit te ofertave, duhet te dorezoje dokumentacionin e kerkuar per punetoret e mesiperm.

Argumentimi: Kjo kërkesë mbështetet në Ligjin Nr. 162, datë 23.12.2020 “Për Prokurimin Publik”, Neni 77, pika 4; në VKM Nr. 285 datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, Kreu V, Seksioni III, Neni 39, pika 6, gërma “c”.

Njësia e Prokurimit duke marrë në konsideratë natyrën e punimeve; makineritë që do të kërkohen për realizimin e punimeve (Shtojca 8) si dhe Preventivin e Punimeve shtron nevojën që Ofertuesit të kenë të punësuar Manovrator me qëllim realizimin e kontratës me sukses. Numri i këtyre punonjësve është përcaktuar duke marrë në konsideratë volumet e punimeve për secilin zë pune mbështetur kjo në VKM Nr. 629 datë 15.07.2015 “Për miratimin e manualeve të çmimeve të punimeve të ndërtimit dhe analizat teknike të tyre”. Gjithashtu me qëllim nxitjen e garës është përcaktuar rasti përjashtimor ku për Manovratorët që janë të kontraktuar me kontratë pune (respektivisht për mjetet e marra me qera), nuk kërkohet të figurojnë në listpagesat e shoqërisë.

Makineritë e rënda të ndërtimit dhe emërtimet bëhen sipas Dëshmime të Aftësive Profesionale (DAP), të cilat ndahen si më poshtë :

- a) eskavator gjermimi e ngarkimi dherash : të të gjitha llojeve si dhe fadromat e të gjitha llojeve (me goma dhe me zinxhirë), manovratorëve u jepet dëshmi për **Eskavatorist**;
- b) automjete për përdorim të veçantë (APV) sipas pikës “g”, të nenit 54, të Kodit Rrugor, makineri ndërtimi mbi bazë automjeti : autovinça, autobetonierë, autopompa betoni, autobitumatriçe, autosonda, autotokmak, manovratorëve u jepet dëshmi për **Automakinist**.

2.3.II Operatori Ekonomik, per realizimin e kontrates, duhet te disponoje mjetet dhe pajisjet e meposhtme:

Nr	Lloji i mjetit/pajisjes teknike	Statusi	Sasia
1	Kamion vetëshkarkues me kapacitet mbajtës minimumi 18 ton	Në pronësi ose me qira	2
2	Kamion vetëshkarkues kapacitet mbajtës min. 10-12 ton	Në pronësi ose me qira	2
3	Kamioncine 3 deri ne 5 ton	Në pronësi ose me qira	1
4	Fadromë	Në pronësi ose me qira	1
5	Grejder me targa	Në pronësi ose me qira	1
6	Eskavator me goma me targa	Në pronësi ose me qira	1
7	Autobetoniere	Në pronësi ose me qira	2
8	Autopompë betoni	Në pronësi ose me qira	1
9	Asfaltoshtruese	Në pronësi ose me qira	1
10	Eskavator me zinxhir	Në pronësi ose me qira	2
11	Autobitumatriçe	Në pronësi ose me qira	1
12	Autobot uji me sprucator	Në pronësi ose me qira	1
13	Rimorkiator (koka terheqes+gjysem rimorkio)	Në pronësi ose me qira/kontrate bashkepunimi	1
14	Rrul me peshë mbi 15 ton	Në pronësi ose me qira	2
15	Rrul me peshë mbi 10 ton	Në pronësi ose me qira	2
16	Rrul max 1 ton per bankinat	Në pronësi ose me qira	1
17	Autovinc me kosh	Në pronësi ose me qira	1

18	Vibrator betoni	Në pronësi ose me qira	2
19	Minieskavator me zinxhir gome	Në pronësi ose me qira	1
20	Autobetoniere vetengarkuese min 2 m3	Në pronësi ose me qira	1
21	Tranxhe per prerjen e kthimin e hekurit	Në pronësi ose me qira	1
22	Armatura druri (betoforma/lend drusore)	Në pronësi ose me qira	500m2
23	Depozite uji 5000l	Në pronësi ose me qira	2
24	Gjenerator 50 kva	Në pronësi ose me qira	1
25	Kontenier stacioner levizes	Në pronësi ose me qira	1
26	Freze asfalti	Në pronësi ose me qira	1
27	Makineri vijezimi	Në pronësi ose me qira	1
28	Kulle ndricimi	Në pronësi ose me qira	1
29	Fabrikë Betoni (e pajisur me leje mjedisore Kodi III.1.B)	Ne pronesi/qera ose Kontrate Furnizimi	1
30	Fabrikë asfalti (e pajisur me lejëmjedisore Kodi III.1.B)	Ne pronesi/qera ose Kontrate Furnizimi	1
31	Nyje Inerte (e pajisur me leje mjedisore Kodi III.1.B)	Ne pronesi/qera ose Kontrate Furnizimi	1

Kriteri i mesiperm konsiderohet i përmbushur me paraqitjen e formularit të vetëdeklarimit sipas shtojcës 8.

Operatori ekonomik i kualifikuar dhe i renditur i pari pas vleresimit të ofertave përparapublikimit të njoftimit të fituesit duhet të paraqesë dokumentacionin e mëposhtëm:

- a) Për mjetet që shënohen në regjistra publikë (mjetet me goma), kur janë në pronësi, duhet të paraqitet dokumentacioni që verteton pronësinë e mjetit:
- leja e qarkullimit;
 - certifikatën e kontrollit teknik;
 - siguracionin;
 - leja/ certifikatën e transportit
 - fotot perkatese ku te duket qartesisht targa dhe lloji i mjetit
- b) Ndërsa për mjete të marra me qira krahas dokumentacionit të mesiperm, duhet të paraqitet edhe kontrata noteriale e qirase dhe dokumentacioni si më poshtë:
- leja e qarkullimit;
 - certifikatën e kontrollit teknik;
 - Siguracionin
 - certifikatën e transportit (në emrin e qeramarresit ose për të tretë, sipas ligjit të kodit rrugor)
 - fotot perkatese ku te duket qartesisht targa dhe lloji i mjetit
- c) Për mjetet që pajisen me certifikatën e transportit për lende të rrezikshme, të paraqitet:
- leja e qarkullimit;
 - certifikatën e kontrollit teknik;
 - Siguracionin
 - certifikatën e transportit për transport mallrash të rrezikshëm lëshuar nga institucionet perkatese (e vlefshme)
 - fotot perkatese ku te duket qartesisht targa dhe lloji i mjetit

ç) Fabrika Betoni (e pajisur me leje mjedisore Kodi III.1.B) Për operatorët ekonomik që kanë kontrata furnizimi të paraqitet vetëm kontrata e furnizimi.

Fabrikë asfalti (e pajisur me leje mjedisore Kodi III.1.B) Për operatorët ekonomik që kanë kontrata furnizimi të paraqitet vetëm kontrata e furnizimi.

Nyje Inerte (e pajisur me leje mjedisore Kodi III.1.B) Per operatoret ekonomik qe kane kontrata furnizimi te paraqitet vetem kontrata e furnizimi.

Autoriteti Kontraktor ka të drejtë të kryejë verifikimet e nevojshme mbi vërtetësinë e informacionit të deklaruar nga operatori ekonomik si më sipër, ose t'i kërkojë operatorit sqarime dhe dokumente mbështetëse për këto sqarime, në përputhje me nenin 26, pika 7, të VKM nr.285, datë 19.05.2021, "Për Miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik"

Argumentimi:

Argumentimi: Në bazë të pikës 4, të nenit të 77, të ligjit nr. 162, datë 23.12.2020 "Për prokurimin publik" dhe nenit 39, pika 6/ç dhe 6/d, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 "Për Miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik", me anë të këtij kriteri kërkohet që operatorët ekonomikë të dëshmojnë që kanë mjetet e pajisjet teknike, të nevojshme për ekzekutimin e objektit të prokurimit, që ka në dispozicion apo që mund t'i vihen në dispozicion operatorit ekonomik për të përmbushur kontratën.

Për të përcaktuar numrin e mjeteve/makinerive të nevojshme për realizimin e kontratës, janë hartuar analizat teknike, sipas legjislacionit të fushës bazuar në VKM nr. 629, datë 15.7.2015, "Për miratimin e manualeve teknike të çmimeve të punimeve të ndërtimit dhe të analizave teknike të tyre" (Ndryshuar me VKM nr. 631, datë 26.10.2018), specififikimet teknike të projektit, volumet e miratuara nga projektuesi.

Mjetet Fadrome, eskavator me zinxhir, minieskavator, janë kerkuar per realizimin e punimeve te germimit per shtresat e rruges.

Sipas preventivit, jane vendosur mjetet Rrula tonazhe te ndryshem asfalti dhe ngjeshjeje, asfaltoshtruese, autobitumatrice, autobot uji, grejder, stabilizues shtresash rrugore per realizimin e punimeve te asfaltit, shtresave te cakullit dhe shtresave te tjera te rruges.

Automjetet me kosh dhe autovincat, jane kerkuar pasi bazuar ne preventivin e punimeve dhe projektin, gjykohen si mjete te domosdoshme per punimet qe do kryhen nga punetoret e kualifikuar ne to.

Fabrikat jane kerkuar si kriter per realizimin e punimeve ne afat dhe me cilesi, konkretisht punimet e shtresave, asfaltit, betonimeve,

:

- Disponimi i punonjësve dhe i mjeteve/pajisjeve të kërkuara do të dëshmohet nëpërmjet paraqitjes së Formularit Përmbledhës të Vetëdeklarimit gjatë fazes së ofertimit.
- Autoriteti/enti kontraktor përpara publikimit të njoftimit të fituesit dhe nisjes së afateve të ankimit, do t'i kërkojë ofertuesit fitues nëpërmjet Sistemit të Prokurimit Elektronik që të dorëzojë dokumentet provuese për vetëdeklarimet e bëra në formularin përmbledhës të vetëdeklarimit, si dhe dokumentet e tjera të kërkuara sipas Shtojcës 8 të DST. Mosparaqitja e dokumentacionit për disponimin e punonjesve, mjeteve/pajisjeve do të jetë kusht s'kualifikimi.
- Autoriteti Kontraktor do të beje verifikimin e dokumentacionit ne perputhje me vetedeklarimin e bere gjate fazes se ofertimit. Konstatimi i mosperputhjeve midis Formularit Përmbledhës të Vetëdeklarimit dhe dokumentacionit të dorëzuar përben kusht s'kualifikimi.

2.3.12 Operatori Ekonomik ofertues duhet të jetë i pajisur me certifikata të lëshuara nga një organ i vlerësimit të konformitetit, i akredituar nga organizmi kombëtar i akreditimit i vendit ku është akredituar ose nga organizma ndërkombëtare akreditues të njohur nga Drejtoria e Përgjithshme e

Akreditimi në Shqipëri (DPA). Certifikatat që kërkohen janë si më poshtë dhe duhet të jenë të vlefshme në kohën e zhvillimit të tenderit:

- Certifikatë për sistemin e menaxhimit të cilësisë ISO 9001:2015 ose ekuivalente,
- Certifikatë për sistemin e menaxhimit të mjedisit ISO 14001:2015 ose ekuivalente,
- Certifikatë për sistemin e menaxhimit të shëndetit dhe sigurisë në punë ISO 45001:2018 ose ekuivalente

Argumentim: Kërkesat e cilësisë të përcaktuara sipas pikës 10 gërma “a”- “e” janë vendosur në mbështetje të Ligjit Nr.162/2020 “Për Prokurimin Publik”, Neni 79, pika 1 ku citohet se: *“Autoriteti ose enti kontraktor për të vërtetuar se punët, mallrat ose shërbimet, objekt prokurimi, i plotësojnë kërkesat e cilësisë, mund t’u kërkojë ofertuesve të paraqesin certifikata të lëshuara nga një organ i vlerësimit të konformitetit, i akredituar nga organizmi kombëtar i akreditimit ose organizma ndërkombëtarë akreditues, të njohur nga Republika e Shqipërisë”*, si dhe në zbatim të Neni 44, pika 1 dhe pika 3 të VKM Nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, ku përcaktohet se: *“Autoriteti/enti kontraktor, për të vërtetuar se punët, mallrat ose shërbimet, objekt prokurimi, i plotësojnë kërkesat e cilësisë, mund t’u kërkojë ofertuesve të paraqesin certifikata të lëshuara nga një organ i vlerësimit të konformitetit, i akredituar nga organizmi kombëtar i akreditimit ose organizma ndërkombëtarë akreditues, të njohur nga Republika e Shqipërisë, vetëm nëse ato janë të argumentuara dhe të lidhura ngushtësisht dhe në mënyrë të drejtpërdrejtë me objektin e prokurimit”*.

ISO 9001:2015 është një seri normash dhe standartizimesh ndërkombëtare, që i referohen sistemeve të menaxhimit të cilësisë, pra, të strukturave të organizimit të ndërmarrjeve publike dhe private, struktura të cilat këto ndërmarrje duhet t’i adoptojnë për një orientim më të mirë të ndërmarrjes në standartet e tregut. AK gjykon se çdo Ofertues duhet të jetë i pajisur me ISO 9001:2015 me qëllim efektivitetin dhe efektshmërinë në zhvillimin e veprimtarisë së tij, e cila do të sjellë dhe zvogëlimin e kostove. Pra ky certifikim do të bëjë të mundur që Ofertuesit të ofrojnë cilësi të mirë me çmime të ulta.

ISO 14001:2015 ofron një kuadër praktik për shoqëritë që duan të menaxhojnë rreziqet mjedisore ekzistuese dhe potenciale. Ky sistem integrohet lehtësisht në strukturën e menaxhimit të biznesit për të kontrolluar impaktet që aktivitetet, operacionet, produktet dhe shërbimet kanë mbi mjedisin. AK gjykon se çdo Ofertues duhet të jetë i pajisur me ISO 14001:2015 me qëllim që veprimtaria e ushtruar nga ana e tij (në rastin konkret realizimi i punës objekt prokurimi) të identifikojë impaktin në mjedis gjatë aktivitetit të saj si dhe të përmirësojë performancën mjedisore duke zbatuar një qasje sistematike. Pra ky certifikim do të bëjë të mundur që Ofertuesit të ushtrojnë veprimtarinë duke pasur në konsideratë parimin e mbrojtjes së mjedisit.

ISO 45001-2018 është standard ndërkombëtar, i cili parashtron kërkesat për menaxhimin e praktikave të mira të sigurisë dhe shëndetit në punë për çdo organizatë, pavarësisht nga madhësia. AK gjykon se çdo Ofertues duhet të jetë i pajisur me ISO 45001-2018 me qëllim që veprimtaria e ushtruar nga ana e tij (në rastin konkret realizimi i punës objekt prokurimi) të realizohet duke u mbështetur mbi parimin e sigurisë dhe shëndetit në punë. Kjo kërkesë shërben dhe si një garanci extra që do të sjellë reduktimin e aksidenteve dhe sëmundjeve në vendin e punës duke minimizuar kostot si dhe kohën në përmbushje me sukses të kontratës së punës objekt prokurimi.

2.3.13 Operatori Ekonomik duhet të paraqesë një kontratë të lidhur me një laborator për këto objekt, i cili të jetë i akredituar nga Drejtoria e Përgjithshme e Akreditimit për analizat e mëposhtme:

1- Beton i fresket sipas standardeve të mëposhtme ose të përditësuara

- SSH EN 206:2013+A1:2016

- SSH EN 12350-2:2009
- 2- Beton i ngurtesuar sipas standardeve te meposhtme ose te perditesuara**
- SSH EN 12390-8:2019
 - SSH EN 12504-2:2004
- 3- Perzierje Bituminoze sipas standardeve te meposhtme ose te perditesuara:**
- S SH EN 12697-5:2018
 - S SH EN 12697-34:2020
 - S SH EN 12697-2:2015+A1:2019
 - S SH EN 12697-6:2020
 - S SH EN 12697-1:2020 ASTM D 2172/2172M-2017e1
- 4- Materiale Rrugore sipas standardeve te meposhtme ose te perditesuara:**
- ASTM D 1556/D 1556M:2015el
 - CNR BU 146

***Argumentimi:** Kerkesat e mesiperme jane vendosur bazuar ne Nenin 79, pika 1 te Ligjit Nr. 162/2020, “Per prokurimin publik”, sipas të cilit: “Autoriteti ose enti kontraktor për të vërtetuar se punët, mallrat ose shërbimet, objekt prokurimi, i plotësojnë kërkesat e cilësisë, mund t’u kërkojë ofertuesve të paraqesin certifikata të lëshuara nga një organ i vlerësimit të konformitetit, i akredituar nga organizmi kombëtar i akreditimit ose organizma ndërkombëtarë akreditues, të njohur nga Republika e Shqipërisë”, si dhe ne zbatim te Neni 44, pika 1 dhe pika 3 të VKM Nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik”, ku përcaktohet se: “Autoriteti/enti kontraktor, për të vërtetuar se punët, mallrat ose shërbimet, objekt prokurimi, i plotësojnë kërkesat e cilësisë, mund t’u kërkojë ofertuesve të paraqesin certifikata të lëshuara nga një organ i vlerësimit të konformitetit, i akredituar nga organizmi kombëtar i akreditimit ose organizma ndërkombëtarë akreditues, të njohur nga Republika e Shqipërisë, vetëm nëse ato janë të argumentuara dhe të lidhura ngushtësisht dhe në mënyrë të drejtpërdrejtë me objektin e prokurimit”*

***Shënim:** Ne lidhje me momentin e paraqitjes se dokumentacionit deshmues per kerkesat qe perfshihen ne formularin permbledhes te vetedeklarimit, mbajme ne konsiderate percaktimet e nenit 26, pika 6, te VKM 285, DT.19.05.2021, i ndryshuar , ku parashikohet qe “Perpara publikimit te njoftimit te fituesit dhe nisjes se afateve te ankimit, autoriteti/enti kontraktor i kerkon ofertuesit te kualifikuar i pari dorezimin e dokumenteve provuese te parashikuara ne shkronjar “a”, “b”, “d”, “dh”, “e”, “h”, “i”, “j”, te pikes 2 te ketij neni , si dhe dokumentet e tjera shoqeruese te ofertes, te dorezuara ne rruge elektronike. Keto dokumente duhet te paraqiten ne original ose ne kopje te njehsuara me origjinalin.*

Të gjitha dokumentet duhet të jenë origjinale ose kopje të noterizuara.

Rastet e mosparaqitjes së një dokumenti, ose dokumente false dhe të pasakta, konsiderohen kushte për skualifikim.

